

Vendim nr. 197, datë 12.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 12.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (R) 2026 të Regjistrat Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ROVENA VODA**, përfaqësuar nga avokatja Eni Shehu (Çobani), me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 26, datë 07.04.2022 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 04, datë 11.01.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-1919, datë 11.12.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 28 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 49/2019 për kryerjen e veprave penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi i parë dhe i dytë, dhe 25 të Kodit Penal (KP). Ky procedim penal është regjistruar ndaj kërkueses dhe shtetaseve F.B. dhe M.H. Ndërsa këto të fundit janë akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 245/1, paragrafi i parë dhe 25 të KP-së, kërkuesja është akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë, i KP-së.

2. Në kushtet kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale ishte i ndryshëm nga ligji në fuqi në kohën e zhvillimit të gjyqimit, bazuar në nenin 3 të KP-së, Prokuroria e Posaçme ka saktësuar ligjin e zbatueshëm për rastin konkret, që është ai më i favorshmi. Pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), e cila, pasi e pranoi atë, vendosi gjykimin e çështjes me procedurë të shkurtuar, duke zbatuar ligjin më të favorshëm për të pandehurat.

3. Në gjykimin e çështjes, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 26, datë 07.04.2022, ndër të tjera, ka vendosur: “Deklarimin fajtores të kërkueses për kryerjen e veprës penale “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë, i KP-së dhe dënimin e saj me një vit e tre muaj burgim. Në bazë të nenit 406, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kërkueses i ulet 1/3-ta e dënimit, për shkak të aplikimit të gjyqimit të shkurtuar, duke u dënuar përfundimisht me dhjetë muaj burgim. Bazuar në nenin 35, paragrafi i parë, të KP-së, kërkueses i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë prej pesë vitesh.”. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm që kërkuesja ka kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm. Në këtë konkluzion GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arritur referuar të dhënave të përfutuara nga vëzhgimet e fshehta të kryera në vende publike, si dhe nga këqyrja e dokumenteve, këqyrja e pamjeve filmike, si dhe komunikimeve me mesazh (sms), prej të cilave arrihet në përfundimin se faktet dhe rrethanat për të cilat të pandehurat F.B. dhe M.H. kanë biseduar dhe kanë komunikuar me njëra-tjetrën, janë fakte dhe rrethana që i kanë biseduar drejtpërdrejt me kërkuesen. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, të pandehurat F.B. dhe M.H. janë takuar disa herë dhe në mënyrë të përsëritur me kërkuesen dhe provohet se, në lidhje me dhënien e shumës monetare prej 1.000 eurosh kërkueses, e pandehura F.B. ka

komunikuar me të pandehurën M.H. jo vetëm përpara se të jepej në formën e përfitimit të parregullt, por ka komunikuar edhe pas dhënies së kësaj shume monetare, të cilën ia ka dhënë personalisht kërkueses, duke shpjeguar hollësisht dhe mënyrën e dhënies së tyre. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se në lidhje me dhënien e aparatit telefonik celular, që rezultoi i blerë në shumën 550 euro, përveç të dhënave të përfutuara nga komunikimet telefonike konfirmohet plotësisht edhe me të dhënat e përfutuara nga këqyrja e pamjeve filmike në një lokal (bar), ku të pandehurat janë takuar dhe kanë qëndruar për disa minuta. Në këtë mënyrë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se duke vlerësuar provat në mënyrë të plotë dhe të lidhura me njëra-tjetrën, arrihet në përfundimin se, kërkuesja, si zëvendësministre, ka pranuar përfitime monetare e materiale të parregullta nga e pandehura F.B., përmes ndërmjetësimi të së pandehurës M.H., me qëllim ushtrimin e ndikimit për punësimin e të pandehurës F.B. në shërbimin civil. Në përfundim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar edhe në lidhje me pretendimet e ngritura nga kërkuesja, duke i vlerësuar ato si të pabazuara, pasi, sipas saj, bazuar në provat e administruara dhe indiciet e evidentuara dhe analizuara, konstatohet se veprat penale kanë ndodhur dhe se ato janë kryer prej të pandehurave, sipas akuzave përkatëse, për të cilat janë sjellë për gjykim. Ndaj vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë ka bërë ankim, ndër të tjera, edhe kërkuesja.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 04, datë 11.01.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 26, datë 07.04.2022 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është i drejtë në lidhje me fajësinë dhe cilësimin juridik të faktit penal të atribuar kërkueses, për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë, i KP-së (para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 43/2021). GJKKO-ja e Apelit, mbështetur në vendimmarrjen e GJKKO-së së Shkallës së Parë, ka vlerësuar se janë të pabazuara kundërshtitë e të pandehurave të këtij gjykimi, përkundrejt fajësisë së deklaruar të tyre, pasi me provat e mbledhura nga Prokuroria e Posaçme, rezultojnë e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, fajësia e tyre për faktin penal të atribuar. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit, nga shqyrtimi tërësor i provave objekt gjykimi, sikundër me të drejtë ka vlerësuar GJKKO-ja e Shkallës së Parë, provohet se kërkuesja, në cilësinë e zëvendësministres në Ministrinë e Brendshme, mbi kërkimin e së pandehurës F.B. për ta ndihmuar këtë të fundit për t'u punësuar në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive dhe nëpërmjet ndërmjetësimi të së pandehurës M.H., ka pranuar dhe ka marrë përfitime të parregullta në shumën 1.000 euro dhe një aparat celular të blerë nga e pandehura F.B. në shumën 550 euro, duke siguruar se zotëron aftësinë për të ushtruar ndikim të paligjshëm në kryerjen e detyrës nga persona që ushtrojnë detyrën

publike, konkretisht në Departamentin e Administratës Publike. Po sipas GJKKO-së së Apelit, nuk ka dyshim që nga përmbajta e përgjimeve telefonike si provë e drejtpërdrejtë e fajësisë të të pandehurave të këtij gjykimi, bisedat ndërmjet tyre rezultojnë të rëndësishme, domethënë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj kundërshtimeve dhe për këtë arsye të besueshme dhe bindëse; të sakta, që nuk janë të përgjithshme dhe jo të ndjeshme nga interpretimet e kundërta, por po aq të barabarta me të vërtetën, prandaj nuk janë të dykuptimta; të përputhura, në kuptimin që nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe për më tepër nuk kundërshtojnë të tjera prova të drejtpërdrejta ose indicie; të gërshetuara e të përputhura jo vetëm me vëzhgimet ambientale, por dhe me rezultatin e komunikimit telefonik të së pandehurës F.B. me nënën e saj, me provat dokument, si dhe me të dhënat e përftuara nga aktet e ekspertimit të aparateve telefonike të sekuestruara të të pandehurave M.H. dhe kërkueses. GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim edhe pretendimet e ngritura në ankim nga kërkuesja, duke i vlerësuar ato të pabazuara, dhe ka arsyetuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vlerësuar në mënyrë të saktë të dhënat e përftuara nga përgjimet telefonike, duke i analizuar ato në raport me të dhënat e tjera të përftuara nga vëzhgimet ambientale, provat dokument, ekspertimet telefonike, të dhënat e përftuara nga këqyrja dhe marrja e pamjeve filmike të lokalit (barit) dhe pamjet filmike të Autoritetit Portual Durrës. Ndaj vendimit të GJKKO-së së Apelit ka paraqitur rekurs, ndër të tjera, edhe kërkuesja.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1919, datë 11.12.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, pasi nuk përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar në mënyrë shteruese elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i KP-së (përpara ndryshimeve të pësura me ligjin nr. 43/2021), në raport me veprimet dhe mosveprimet e secilës prej të pandehurave, si dhe në raport me provat e administruara në gjykim, duke vlerësuar se ato duhen deklaruar fajtores. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, gjykatat e faktit kanë vlerësuar drejt provat e paraqitura nga organi i akuzës për sa i përket standardit të provueshmërisë në procesin penal tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në respektim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Për sa u përket shkaqeve të rekursit, Kolegji Penal ka arsyetuar se ato janë parashtruar edhe në ankimin e paraqitur pranë GJKKO-së së Apelit, e cila u ka dhënë përgjigje shteruese dhe ligjore. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se GJKKO-ja e Apelit ka kryer një proces gjyqësor në përputhje me parimet bazë të procesit penal dhe në vendimmarrjen e saj nuk konstatohen shkelje që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, shkelje që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e

provave, ose që vendimi i gjykatës së apelit vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 24.03.2026 (sipas shënimit të shërbimit postar) kërkesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 03.04.2026.

II

Pretendimet e kërkeses

7. **Kërkesja** ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se është cenuar:

7.1. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar pse nuk duhet të merreshin në konsideratë pretendimet e mbrojtjes, analiza e provave të së cilës ishte në favor të kërkeses. Nga mënyra sesi janë shprehur gjykatat në arsyetimin e tyre, konstatohet se ato e kanë paragjykuar çështjen e kërkeses. Paragjykimi i çështjes vërehet edhe nga fakti se kur ajo po gjykohej në GJKKO-në e Apelit, ish-drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në një intervistë publike ka deklaruar si rast suksesi dënimin e saj me vendim përfundimtar të formës së prerë, ndërkohë që çështja ishte në gjykatën e apelit. Gjykatat e kanë dënuar kërkesen vetëm mbi bazën e indicieve/përgjimeve të të dy të pandehurave të tjera. Nga analiza e kryer mbi bazën e kryqëzimit të të dhënave të përfutuara nga përgjimet ambientale me provat e ndodhura në fashikullin e gjykimit, konstatohet se ato (përgjimet) nuk arrijnë të marrin fuqi provuese për faktin penal të pretenduar nga organi i akuzës dhe as të provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se fakti penal ekziston dhe është kryer nga kërkesja. Në arsyetimin e tyre gjykatat kanë anashkaluar deklaratat e të pandehurave dhe nuk i kanë konsideruar ato, duke pasur bindjen se dhurata është pranuar si përfitim i parregullt.

7.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk përmbushur detyrimin e tyre për arsyetimin e vendimeve, për shkak se vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është i pakuptueshëm dhe kundërshton vetveten. Ai vendim është në kundërshtim me shkaqet e tij dhe nuk citon arsytet lidhur me faktet vendimtare. Në disa pjesë të vendimit përmenden persona që nuk kanë lidhje me çështjen ose gabohet në identitet, duke u krijuar konfuzion në paragrafët e nenit 245/1 të KP-së, të cilët i atribuohen kërkeses. Po ashtu, në atë vendim mungon analiza e kryqëzuar

e provave, mungon analiza e kryqëzuar e vet indicieve me njëra-tjetrën ose e indiceve dhe provave shkresore me njëra-tjetrën. Ajo gjykatë nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve të ngritura nga kërkuesja. Po ashtu, edhe GJKKO-ja e Apelit, edhe pse në ankim ishin ngritur pretendime për shkelje procedurale në drejtim të çmuarjes jo të saktë e të plotë të provave nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, nuk i mori në konsideratë ato. GJKKO-ja e Apelit ka dështuar të bëjë një arsyetim të plotë të bazuar në një analizë të hollësishme të përgjimeve/indicieve me njëra-tjetrën. Arsyetimit të gjykatave i mungon analiza krahasuese e përgjimeve me provat e tjera. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs nga kërkuesja, si atyre me natyrë kushtetuese, ashtu edhe atyre që lidhen drejtpërdrejt me funksionin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji.

7.3. *Parimi i barazisë përpara ligjit* (uniformiteti i zbatimit të ligjit), pasi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë në vendimmarrjet e tyre nuk janë orientuar nga jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mos respektuar praktikën e atij kolegji që lidhet me çështjet e çmuarjes së provave dhe elementeve të veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm. Ato gjykata kanë arritur në një konkluzion të gabuar për sa i përket fajësisë së kërkueses, duke mos e provuar atë tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Interpretimi që ka bërë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2024-1823, datë 14.11.2024, në lidhje me analizën e akuzës së ngritur ndaj një ish-zyrtari shtetëror për veprime korruptive, ka krijuar pritshmëri te kërkuesja se nën dritën e këtij interpretimi do të vlerësoheshin edhe pretendimet e saj të ngritura në rekurs.

7.4. *Vlerësimi i provave*, pasi gjykatat e faktit kanë dështuar të bëjnë një vlerësim të plotë dhe të kryqëzuar të provave dhe janë fokusuar vetëm në analizën e disa përgjimeve midis të pandehurave të tjera, duke u dhënë atyre vlerë të paracaktuar dhe duke anashkaluar provat e tjera. Ndërkohë, në dosjen gjyqësore nuk ekziston asnjë përgjim i kërkueses. Kërkuesja është dënuar pa asnjë provë, bazuar në thashetheme të personave të tjerë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimitetit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj në seancë plenare.

10. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitetit për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuuesja në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se, në thelb, ajo ka pretenduar se është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimi i barazisë së armëve*, si dhe *standardi i vlerësimit të provave*.

11. Lidhur me pretendimin për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, Kolegji konstaton se kërkuuesja ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë në vendimmarrjet e tyre nuk janë orientuar nga jurisprudenca e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mos respektuar praktikën e atij kolegji që lidhet me çështjet e çmuarjes së provave dhe elementeve të veprës penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur janë ngritur pretendime në lidhje me cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit për mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të

justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimin nr. 19, datë 21.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në vështrim të këtij standardi, Kolegji evidenton jo vetëm se kërkuesja nuk ka sjellë asnjë argument konkret se si dhe pse çështja e saj nuk është trajtuar nga Gjykata e Lartë në mënyrë të barabartë me raste të tjera, po edhe se kjo e fundit në vendimmarrjen e saj nuk rezulton të ketë vendosur në mënyrë të ndryshme me ndonjë vendim unifikues a njëses të praktikës gjyqësore. Për rrjedhojë, fakti që Kolegji Penal i asaj gjykate ose GJKKO-ja e Apelit mund të ketë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, nuk përbën argument që mund të mbështesë pretendimin për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga pikëpamja kushtetuese në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit.

14. Po ashtu, Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se vlerësimi i provave është atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa juridiksionit kushtetues i takon të verifikojë nëse, gjatë këtij vlerësimi, janë respektuar standardet kushtetuese (*shih vendimet nr. 20, datë 24.02.2026; nr. 8, datë 20.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, referuar argumenteve të sjella nga kërkuesja në mbështetje të pretendimeve të saj në drejtim të cenimit të *standardit të vlerësimit të provave*, Kolegji konstaton se ato, në thelb, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave mbi bazën e të cilave gjykatat kanë arritur në përfundimin e tyre për deklarimin fajtores të kërkueses për veprën penale për të cilën është akuzuar, të cilat, si të tilla, nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Kërkuesja nuk ka sjellë asnjë argument konkret kushtetues për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nga gjykatat e zakonshme në këtë drejtim. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkueses nuk hyn në juridiksionin kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Në ankimin kushtetues individual kërkuesja ka pretenduar se është cenuar edhe *parimi i prezumimit të pafajësisë*, duke argumentuar, në thelb, se sipas saj gjykatat nuk kanë arsyetuar pse nuk duhet të merreshin në konsideratë pretendimet e mbrojtjes, analiza e provave të së cilës ishte në favor të kërkueses. Sipas kërkueses, nga mënyra sesi janë shprehur gjykatat në arsyetimin e tyre, konstatohet se ato e kanë paragjykuar çështjen e saj dhe ky paragjykim është konstatuar edhe nga deklaratat e ish-drejtnesit të Prokurorisë së Posaçme, ndërkohë që çështja po gjykohej në GJKKO-në e Apelit.

17. Gjykata ka theksuar se në rastin e gjyqimit penal parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë

të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në analizë të vendimmarrjes të gjykatave të zakonshme dhe Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, ato gjykata kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Ato nuk u kanë dhënë prioritet provave të paraqitura nga organi i akuzës, nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesja dhe nuk kanë nxjerrë prezumime fakti të paarsyeshme. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, Kolegji konstaton se gjykatat në vendimet e tyre kanë arsyetuar pse nuk duhet të merreshin në konsideratë pretendimet e mbrojtjes, duke arsyetuar, gjithashtu, vendimet e tyre bazuar në provat e administruara në gjykim (*shih paragrafët 3-5 të vendimit*). Nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara rezulton se gjykatat i kanë vlerësuar provat në ngarkim të kërkueses në raport me njëra-tjetrën, duke i dhënë edhe mundësinë asaj që, në kushte të barabarta me organin e akuzës, të parashtrojë pretendimet e saj dhe të kundërshtojë akuzën e ngritur dhe provat mbi të cilat është ngritur kjo akuzë, si dhe të paraqesë prova e të debatojë në lidhje me to. Gjykatat kanë arritur në përfundimin se kërkuesja ishte autore e veprës penale “Ushtimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi i dytë, i KP-së, pa i dhënë ndonjëherë prej provave të shqyrtuara vlerë të paracaktuar. Nga arsyetimi i gjykatave, vendimet e të cilave janë kundërshtuar nga kërkuesja, rezulton se ato kanë arritur në përfundimin për fajësinë e kërkueses, pasi kanë kryer një proces të shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të administruara në gjykim, duke mos arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e saj dhe duke mos u bazuar në deklaratat e ish-drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, por e kanë përcaktuar atë tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe arsyetuar mjaftueshëm në këtë drejtim.

19. Për më tepër, rezulton se ky pretendim i kërkueses (parimi i prezumimit të pafajësisë) ka marrë përgjigje të arsyetuar si nga GJKKO-ja e Apelit (*paragrafi 4 i këtij*

vendimi), ashtu dhe nga Gjykata e Lartë, ku kjo e fundit në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë ligji, bazuar dhe në parimin e subsidiaritetit, ka arsyetuar se GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar në mënyrë shteruese elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 245/1 i KP-së (përpara ndryshimeve të pësura me ligjin nr. 43/2021), në raport me veprimet dhe mosveprimet e secilës prej të pandehurave, si dhe në raport me provat e administruara në gjykim, duke vlerësuar se ato duhen deklaruar fajtores dhe se gjykatat e faktit kanë vlerësuar drejt provat e paraqitura nga organi i akuzës për sa i përket standardit të provueshmërisë në procesin penal tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe në respektim të parimit të prezumimit të pafajësisë (*paragrafi 5 i këtij vendimi*).

20. Për sa më lart, Kolegji evidenton se kërkuesja është gjykuar mbi bazën e të gjitha provave të ndodhura në fashikullin gjyqësor, pra përgjimeve, komunikimeve me mesazhe (sms), këqyrjes së pamjeve filmike dhe provave të tjera, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat se provojnë fajësinë e saj përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndaj nuk qëndron argumenti se gjykatat të kenë arritur në një konkluzion *a priori* për fajësinë e saj. Për këto arsye, pretendimi i kërkueses për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është haptazi i pabazuar.

21. Kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi, sipas saj, gjykatat nuk përmbushur detyrimin e tyre për arsyetimin e vendimeve. Sipas kërkueses, vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë është i pakuptueshëm dhe kundërshton vetveten, si dhe në disa pjesë të vendimit përmenden persona që nuk kanë lidhje me çështjen ose gabohet në identitet, duke u krijuar konfuzion në paragrafët e nenit 245/1 të KP-së, të cilët i atribuohen kërkueses. Po ashtu, kërkuesja ka pretenduar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk i ka dhënë përgjigje asnjë prej pretendimeve të ngritura prej saj. Për sa i përket vendimit të GJKKO-së së Apelit, kërkuesja ka pretenduar se ajo gjykatë nuk i ka marrë në konsideratë pretendimet e saj të paraqitura në ankim që lidheshin me shkelje procedurale në drejtim të çmuarjes jo të saktë e të plotë të provave nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë. Ndërsa lidhur me vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kërkuesja ka pretenduar se ai nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në rekurs.

22. E drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 70, datë 15.10.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor,

në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata është shprehur se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Për sa më lart, në rastin konkret, duke iu referuar arsyetimit të vendimeve të kundërshtuara nga kërkuesja, Kolegji konstaton se ato plotësojnë kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tyre. Vendimet e gjykatave nuk janë jokohërente ose që të kenë kundërthënie ose kontradiksion, ndërkohë që pjesët arsyetuese janë të mjaftueshme për të mbështetur ato që janë vendosur në pjesën urdhëruese. Ato vendime nuk rezultojnë të jetë alogjike dhe të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesja, rezultojnë se gjykatat kanë marrë në shqyrtim dhe pretendimet e saj, duke i vlerësuar ato si të pabazuara, dhe duke arsyetuar vendimmarrjen e tyre në këtë drejtim. Gjykatat e zakonshme e kanë mbështetur vendimin për fajësinë e kërkueses në një sërë provash, të cilat i kanë pasqyruar në pjesën arsyetuese dhe i kanë vlerësuar të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Gjykatat qartazi kanë arsyetuar se kërkuesja është dënuar mbi bazën e të gjitha provave të marra në gjykim (*paragrafët 3-5 të këtij vendimi*).

24. Për sa u përket argumenteve të kërkueses se GJKKO-ja e Shkallës së Parë në disa paragrafë të vendimit të saj u referohet personave që s'kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi ose se gabon në identitetin e kërkueses, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore,

vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 5, datë 29.01.2025; nr. 30, datë 18.04.2024; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, në lidhje me këto argumente të kërkuases, Kolegji evidenton se ky gabim material në vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë nuk është thelbësor në drejtim të të drejtave të kërkuases dhe nuk është i tillë që të vërë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj saj. Nga ana tjetër, kërkuessa nuk e lidh atë me ndonjë pasojë të drejtpërdrejtë të ardhur në të drejtën e saj për proces të rregullt ose me shkaqe të tjera që kanë cenuar substancialisht këtë të drejtë, në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, i cili ashtu siç edhe u argumentua më sipër është përmbushur nga vendimi i GJKKO-së së Shkallës së Parë.

25. Nga ana tjetër, Kolegji konstaton se edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga sa pretendon kërkuessa, përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e tij, pasi ka arsyetuar shkaqet se pse rekursi i saj nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 432 i KPP-së. Po ashtu, rezulton se ai kolegji u ka dhënë përgjigje në thelb pretendimeve të kërkuases të ngritura në rekurs, si atyre me natyrë kushtetuese, ashtu edhe atyre që lidhen drejtpërdrejt me funksionin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, duke e vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta. Për këto arsye, Kolegji vëren se pretendimi i kërkuases për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është haptazi i pabazuar.

26. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji vlerëson se nuk është i nevojshëm analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues të individual të kërkuases.

27. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.